


Përmbledhje e Matricës së Monitorimit për Mjedisin Mundësues të Zhvillimit të Shoqërisë Civile

Zhvillimet Kryesore në Shoqërinë Civile në Kosovë gjatë vitit 2024



Në vitin 2024, ambienti për shoqëri civile në Kosovë u karakterizua me zhvillime të konsiderueshme legjislative, sfida financiare në rritje, si dhe përfshirje të kufizuar në vendimet kryesore të politikbërjes.

Korniza ligjore dhe e politikave për shoqërinë civile në Kosovë, gjatë vitit 2024 ishte kryesisht mundësuese dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare. **Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare garanton të drejtën për të themeluar dhe operuar lirshëm OJQ-të, dhe zbatimi i tij në përgjithësi ishte i kënaqshëm.** Organizatat e shoqërisë civile, përfshirë ato të angazhuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë, vazhduan të vepronin pa ndërhyrje ose pengesa të ndryshme, të paarsyeshme nga autoritetet shtetërore, duke reflektuar një mjedis në përgjithësi të hapur për lirinë e asociimit.

Megjithatë, zhvillimet ligjore dhe rregullative që kanë ndodhur në vitin 2024 për të mbështetur zbatimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit u përcollën me shqetësime për ndikimin e tyre të mundshëm në mjedisin mundësues për shoqërinë civile. U miratuan dy akte nënligjore: **Udhëzimi Administrativ për Regjistrimin, Funksionimin dhe Çregjistrimin e OJQ-ve, dhe një Rregullore për themelimin e një Komisioni Ankesash për OJQ-të.** Ndërsa ndryshimet ligjore synonin të sqaronin detyrimet ekzistuese ligjore, si kërkesa për kapital minimal për themelimin e fondacioneve dhe zbatimi i gjobave për përditësimet e vonuara në regjistrin publik të OJQ-ve, ato gjithashtu prezantuan një mekanizëm të ankimit të shkallës së dytë dhe një sërë ndryshimesh procedurale, duke përfshirë zgjatjen e afatit për t'iu përgjigjur kërkesave të OJQ-ve nga **30 në 45 ditë**. Ky afat i ri kohor zbatohet për procedura të ndryshme, si regjistrimi, dhënia apo revokimi i statusit të përfitimit publik. Periudha 45-ditore e shqyrtimit, veçanërisht për regjistrim të OJQ-së, është skajshmërisht e lartë dhe në shpërputhje me standardet ndërkombëtare për ushtrim të lirisë së asociimit, dhe praktikatat e të gjitha vendeve të rajonit. Për ta konkretizuar më shumë, afati ligjor për regjistrim të bizneseve në ARBK për **çdo lloj biznesi** varion nga **2 deri në 7 ditë** maksimumi. Për më tepër, historikisht Departamenti për OJQ-të ka trajtuar një numër të ulët kërkesash për regjistrim, mesatarisht dy në muaj, dhe në kohë relativisht të shpejtë, zakonisht brenda një jave deri në dhjetë ditë.

Organi i shkallës së dytë për trajtimin e ankesave ndaj vendimeve nga Departamenti i OJQ-ve u themelua zyrtarisht me **Rregulloren (MPB) nr. 01/2024 për themelimin, përbërjen, mandatin, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Ankesave për Organizatat Joqeveritare.** Rregullorja kishte për qëllim kryesisht të harmonizonte procedurat që lidhen me OJQ-të me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të zvogëlonte rastet e panevojshme gjyqësore. Edhe pse ky ndryshim sjellë qartësi ligjore dhe zvogëlon varësinë nga gjykatat për zgjidhje të mosmarrëveshjeve administrative, procesit të hartimit të tij i mungoi pjesëmarrja e shoqërisë civile. Shoqëria civile nuk u përfshi fare në grup punues për hartim të Rregullores, derisa Rregullorja u publikua zyrtarisht për konsultim publik, platforma online e konsultimit nuk funksionoi siç duhet, duke i penguar institucionet që të kenë qasje në komentet e paraqitura, dhe kontributi i OShC-ve përfundimisht u shpërfill. Përbërja e Komisionit të Ankesave mbetet e dominuar nga përfaqësues të emëruar nga qeveria.

Ligji i ri për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) u miratua në mars të vitit 2024, me qëllim reformimin e kornizës ligjore dhe rregulluese për mediat audiovizuale. Ky ligj nuk i adreson drejtpërdrejtë OShC-të, por pritet të zgjerohet për të përfshirë OShC-të që merren me mediat. Ligji i propozuar u përball me kritika të forta nga gazetarët dhe shoqëria civile, të cilët ngritën shqetësime në lidhje me kërkesën që platformat e publikimit të përmbajtjes audio ose video të regjistrohen në KPM sikurse televizionet dhe radiostacionet, si dhe për funksionimin e përgjithshëm të pavarur të KPM-së. Më 23 prill 2025, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shfuqizoi ligjin e ri pas një kundërshtimi ligjor nga deputetët e opozitës, duke theksuar mospërputhjet me parimet kushtetuese.

Lidhur me qasjen në burime financiare për OJQ-të, dy zhvillime legjislativë patën implikime të ndryshme për OShC-të. **Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (PPL/LFT) u ndryshua** nga qeveria pa konsultim publik në platformën online për konsultime. Zhvillimi pozitiv në kuadër të avokimit për PPP/LFT është se projektligji i ri, i miratuar në nëntor të vitit 2024 nga Kuvendi, i ka hequr OJQ-të nga lista e subjekteve raportuese. Ky ndryshim pritet të lehtësojë barrën e rëndë administrative dhe raportuese, dhe të zvogëlojë stigmën që lidhet me klasifikimin e tyre si sektor me rrezikshmëri të lartë. Për më tepër, kjo iniciativë përputhet me praktikën e mira ndërkom-bëtare që rekomandojnë një qasje më të balancuar dhe të bazuar në rrezik. Ajo ruan sigurinë financiare pa penguar rolin kyç të OJQ-ve në shoqërinë civile dhe në promovimin e demokracisë dhe transparencës.

Megjithatë, pavarësisht miratimit të tij nga Kuvendi, Ligji i ri ende nuk ka hyrë në fuqi, pasi është dërguar në Gjykatën Kushtetuese nga deputetët e opozitës. Ligji është pjesë e një pakete më të gjerë legjislativë të miratuar gjatë seancës së Kuvendit të mbajtur më 13.11.2024, procedurën e miratimit të së cilës opozita e ka kundërshtuar. Paralelisht, vlerësimi i rrezikut sektorial për OJQ-të i filluar disa vite më parë ka shënuar përparim të konsiderueshëm gjatë vitit 2024 dhe pritet të finalizohet së shpejti.

Miratimi i Ligjit nr. 08/L-265 për Regjistrin e Pronarëve Përfitues synon të krijojë një sistem të koordinuar dhe të qasshëm për identifikimin e individëve që ushtrojnë kontroll mbi subjektet juridike në Kosovë. Kjo nismë ka për qëllim të harmonizojë legjislativën e Kosovës me standardet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) dhe Direktivën e 5-të të BE-së kundër Pastrimit të Parave (5AMLD), duke rritur transparencën dhe duke parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Megjithatë, përkufizimi i pronësisë përfituese për OJQ-të në këtë ligj është problematik, pasi barazon në mënyrë të pasaktë themeluesit me personat që ushtrojnë kontroll efektiv, duke anashkaluar strukturën e qeverisjes së OJQ-ve të përcaktuara me Ligjin për Lirinë e Asociimit. Për më tepër, ligji vendos gjyba joproporcionale për OJQ-të duke aplikuar ndëshkime monetare uniforme që nuk bëjnë dallim midis akterëve komercialë me rrezik të lartë dhe organizatave jokomerciale me rrezik të ulët, siç janë OJQ-të.

Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve mbeti e njëjtë në vitin 2024 si në vitet e mëparshme. Financimi publik për OJQ vazhdoi të ofrohet si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel lokal përmes proceseve konkurruese. Për herë të parë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MRKS) prezantoi një model premtues të mbështetjes institucionale dhe afatgjatë duke lansuar një skemë trevjëqare financimi që synon zhvillimin organizativ dhe programatik të OJQ-ve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Sipas **platformës online të Qeverisë për raportimin e financimit të OJQ-ve**, gjatë vitit 2024 OJQ-ve iu ndanë 8.68 milionë euro nga niveli lokal dhe qendror. Megjithatë, transparenca dhe mbikëqyrja e financimit publik u përkeqësuan më tej. Ndërsa në vitet e mëparshme platforma funksiononte me besueshmëri të pjesshme, në vitin 2024 ajo shënoi një rënie të ndjeshme të performancës. Shumë institucione nuk arritën të publikonin të dhënat e tyre, ndërsa disa të tjera ngarkuan të dhëna të dyfishta ose **jo të plota**, duke rezultuar në mospërputhje prej pothuajse 5 milionë eurosh. Asnjë institucion qeveritar nuk ka marrë përgjegjësinë për sigurimin e integritetit të të dhënave, ndërsa Zyra për Qeverisje të Mirë ende nuk ka zbatuar një mekanizëm efektiv të kontrollit të cilësisë së tyre.

Sa i përket mbështetjes jofinanciare shtetërore për OShC-të, korniza ligjore që rregullon qasjen në pronën komunale mbeti një çështje kyçe në vitin 2024. Prona publike vazhdon të jetë një nga format e pakta të mbështetjes së prekshme në dispozicion të OShC-ve në Kosovë, veçanërisht në nivel lokal. Në praktikë, ajo u është alokuar kryesisht bizneseve dhe jo organizatave të shoqërisë civile. Në dhjetor të vitit 2023, Qeveria miratoi një **projektligj të ri për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale** dhe e paraqiti atë në **Kuvend**. Edhe pse projektligji kaloi në leximin e parë në vitin 2024, ai binte ndesh me objektivat e përcaktuara në Koncept Dokumentin origjinal duke kufizuar përdorimin e pronës komunale vetëm për interesa ekonomike, duke përjashtuar kështu qëllimet që lidhen me përfitimin shoqëror ose publik.

Projektligji, në formën në të cilën ishte prezantuar, shpërfillte interesin publik dhe rrezikonte institucionalizimin e praktikave që mund të mundësonin keqpërdorimin e pronës publike për përfitime politike ose komerciale. Në përgjigje, një koalicion i OJQ-ve, të udhëhequra nga KCSF-ja u mobilizua për të avokuar kundër këtij legjislacioni të propozuar. Këto përpjekje rezultuan me sukses, duke bërë që Kryetari i Kuvendit të tërheqë Ligjin nga Kuvendi, dhe të nisë një grup pune parlamentar për rishikimin e draftit. Gjatë këtij procesi, KCSF-ja hartoi një grup alternativ të dispozitave ligjore që adresonin aspektet më kritike të ligjit dhe **arriti që shumë nga këto dispozita të përfshihen në amendamentet parlamentare**. Fatkeqësisht, mandati legjislativ përfundoi përpara miratimit të draftit nga Kuvendi, duke e bërë të nevojshëm rifillimin e procesit nga e para, kur të ketë legjislaturë dhe Qeveri të re.

Edhe pse pezullimi i menjëhershëm i ndihmës së jashtme amerikane u njoftua zyrtarisht në janar të vitit 2025, ai nxori në pah brishtësinë strukturore të shoqërisë civile të Kosovës, dhe varësinë e saj nga donatorët ndërkombëtarë. Më shumë sesa një tronditje financiare, ky zhvillim rrezikon të zhbëjë një ekosistem shumë dekadësh të zhvillimit demokratik, pjesëmarrjes dhe besimit publik. Sipas studimit të KCSF-së, një total prej 28.22 milionë dollarësh ishte alokuar përmes 68 granteve dhe kontratave aktive, disa afatgjata dhe me vlerë të lartë, të tjera afatshkurtra dhe me fushëveprim më të vogël. Totali i fondeve që parashikohet të humben midis fundit të janarit 2025 dhe datave origjinale të përfundimit të kontratave arrin në 11.61 milionë dollarë. Programet më të prekura janë ato që u shërbejnë të rinjve, grupeve të cënueshme, të drejtave të grave, angazhimit qytetar dhe medias së pavarur.

Strategjia e re Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2025–2030 filloi të hartohet në vitin 2024, një vit pas përfundimit të strategjisë së mëparshme në 2023. Procesi u udhëhoq nga Zyra për Qeverisje të Mirë dhe përfshinte konsultime me shoqërinë civile. Drafti parasheh katër objektiva kryesore: promovimin e pjesëmarrjes qytetare, sigurimin e financimit të qëndrueshëm dhe transparent, formalizimin e përfshirjes së OShC-ve në ofrimin e shërbimeve publike, dhe nxitjen e vullnetarizmit.

Kontraktimi i shërbimeve nga OJQ-të mbeti nën shqyrtim rregullativ gjatë vitit 2024. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nisi në fund të vitit 2023 një proces hartimi për të vendosur procedura më të qarta për kontraktimin e shërbimeve nga OJQ-të, fillimisht si rregullore, e cila më vonë u riklasifikua si Udhëzim Administrativ. Drafti, i përgatitur me kontributin e institucioneve kryesore publike dhe katër përfaqësuesve të OShC-ve, synon të përmirësojë qartësinë procedurale, dhe qëndrueshmërinë financiare. Konsultimet vazhduan gjatë gjithë vitit 2024 dhe përfunduan në dhjetor, por procesi i miratimit të këtij Udhëzimi Administrativ mbetet i pa përmbyllur.

Në vitin 2024, konsultimi publik mbeti kryesisht procedural dhe nuk arriti të mundësojë përfshirje kuptimplotë të OShC-ve. Edhe pse pothuajse 80% e të gjithë legjislacionit dhe dokumenteve të politikave të hartuara u vunë për konsultim me shkrim ose online, procesi mbeti kryesisht performativ në praktikë, duke dështuar të sigurojë angazhim të hershëm, llojllojshmëri dhe përfshirje të metodave të pjesëmarrjes dhe mungesë të reagimit institucional ndaj kontributit publik. Performanca e Platformës Online për konsultime publike u përkeqësua më tej në vitin 2024, duke u pamundësuar në disa raste institucioneve shqyrtimin apo përgjigjen e komenteve të publikut. Megjithatë, pavarësisht këtyre sfidave, OShC-të dhe qytetarët mbetën dy kontribuesit më aktivë në procesin e konsultimit online gjatë vitit 2024.

Në përgjithësi, sektori i shoqërisë civile në Kosovë vazhdon të tregojë qëndrueshmëri dhe përkushtim pavarësisht pasigurisë financiare në rritje dhe regresit legjislativ. Ndryshimet ligjore që ndodhën gjatë vitit 2024 ofrojnë një bazë strukturore për bashkëpunim më të fortë midis institucioneve dhe shoqërisë civile. Avokimi i shoqërisë civile luajti gjithashtu një rol kyç në parandalimin e ligjeve potencialisht të dëmshme. Megjithatë, këto arritje mbeten të brishta pa sigurimin e një financimi të qëndrueshëm, pjesëmarrjeje aktive dhe masave të forta mbrojtëse. Adresimi i këtyre boshllëqeve është thelbësor për ruajtjen e llogaridhënies demokratike, nxitjen e angazhimit qytetar dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të sektorit.

Autor dhe botuar nga:

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)
Musa Tolaj, Lam A, Hyrja 1, Kati i 12-të, nr. 65-1
Qendra Nartel, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel.: +383 (0)38 600 633, +383 (0)38 600 644
E-mail: office@kcsfoundation.org
www.kcsfoundation.org

Maj 2025

Si të citohet ky publikim:

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).
Përmbledhje e Matricës së Monitorimit për vitin 2025:
Zhvillimet kryesore në shoqërinë civile në Kosovë gjatë vitit 2024.
KCSF, maj 2025.

Shënim:

Ky tekst është përkthyer në gjuhën shqipe nga versioni origjinal në gjuhën angleze.
Në rast dallimesh në interpretim, versioni në gjuhën angleze konsiderohet si version zyrtar.

